



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

14-026/04-00533579/18, më 06. U.S. 2018

Në bazë të neneve 13 të Ligjit nr.03/L – 040, për vetëqeverisjen lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 6 të ligjit nr. 03/L – 128, për auditimin e brendshëm, të neneve 3 dhe 4 të udhëzimit administrative nr.11/2010, për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, të nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391 të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET vendimi për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të auditimit brendshëm në Komunën e Prishtinës.
- II. Komitetit për auditim të brendshëm është në këtë përbërje:
 1. Visar Berisha– Kryesues;
 2. Blerina Uka- anëtare dhe
 3. Milaim Peci- anëtar
- III. Drejtori i Njësisë së auditimit të brendshëm do të jetë sekretar i komitetit të cekur në pikën I të vendimit, në cilësinë e përcjellësit të takimit të Komitetit.
- IV. Mandati i anëtarëve të Komitetit të auditimit të cekur në pikën II të këtij vendimi është tre (3) vjeçar, me të drejtë riemërimin dhe për një mandat tre (3) vjeçar.
- V. Detyrë e komitetit të cekur në pikën I të këtij Vendimit është: ofrimi i këshillave të menaxhmentit për KBFP, të sigurojë që menaxhmenti i SSP-së realizon veprimtarinë në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet ligjore, të rishikojë dhe aprovoj planet vjetore të NJAB, të rishikoj raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm, deklaratat financiare, përgjigjen e menaxhmentit ndaj çështjeve të ndritura nga auditimi i jashtëm, të mbrojnë pavarësinë funksionale të NJAB dhe detyra tjera të parapara nga pikat 1.9 deri te pika 1.14 të nenit 4 të Udhëzimit administrativ.

Faqe 1 nga 2

- VI. Komiteti i auditimit përgatit raportin vjetor për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik. Raporti duhet të përfshijë pjesët e parapara nga pika 1.1 deri te pika 1.7 të nenit 7 të udhëzimit administrativ.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimit do te kujdeset Kryetari i Komunës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij.

Ju dërgohet

- anëtareve të Komitetit;
- drejtorit të NJAB dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti